



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. Prot.

Tiranë, më

2019

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____ 2019

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”
“Mbi auditimin e përputhshmërisë për periudhën nga data 01.09.2017 deri më datën 30.09.2019”

Nga auditimi i ushtruar rezultuan disa problematika në përmbajtjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor që rregullon shqyrtimin e ankesave në procedurat e prokurimeve publike, të cilat janë devijime jo materiale sasiore dhe jo të përhapura që nuk kanë cenuar thellësisht funksionimin e këtij institucioni, prandaj justifikojnë dhënien e një opinioni të përputhshmërisë të pakualifikuar me theksim çështje.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, këtë auditim me objekt “Auditim Përputhshmërie” e përqendroi vetëm në zbatimin e rregullshmërisë për procedurat e ndjekura në trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe nuk auditoi ligjshmërinë e Vendimmarrjeve të KPP.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë” të ushtruar në Komisionin e Prokurimit Publik, sipas programit të auditimit 802/1, datë 15.10.2019, për veprimtarinë nga data 01.09.2017 deri më datën 30.09.2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Për drejtimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP):

Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditimin e përputhshmërisë e përqendroi vetëm në zbatimin e rregullshmërisë për procedurat e ndjekura në trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion shqyrton ankesat në fushën e prokurimeve publike, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në të cilën janë konstatuar mangësi dhe parregullsi jo thelbësore. Gjatë auditimit janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion shqyrton ankesat në fushën e prokurimeve publike, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në të cilën janë konstatuar mangësi dhe parregullsi jo thelbësore. Gjatë auditimit janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i pakualifikuar me theksim çështje:

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Komisionin e Prokurimit Publik, rezultuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat kryesisht konsistojnë në tejkalim të afateve të vendimmarrjeve në shqyrtimin e ankesave, të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë jo materiale dhe jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të përputhshmërisë të pakualifikuar me theksim çështje.

Baza për opinionin e pakualifikuar me theksim çështje (ISSAI 4000)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të mjaftueshme të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

B. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² ISSAI 4000 – Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

³ Një opinion i pakualifikuar me theksim çështje shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar, *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

1. Gjetje nga auditimi: Në pikën 2 të nenit 23 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP që bënë fjalë për “*Caktimi i çështjeve dhe njohja me aktet*”, përcaktohet se:

“Për çështje me vlerë të fondit limit më të lartë se kufiri i ulët monetar, çështja i caktohet me short tre anëtarëve dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të relatorit të parë të përcaktuar nga shorti si më sipër”.

Siç shikohet fjalia që, në rast se, ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të relatorit të parë të përcaktuar nga shorti, lejon hapësira për interpretime të ndryshme apo keq interpretime në vendimmarrjet e komisionit. Sepse në rast se, ka mendime të ndryshme dhe dy nga relatorët kanë mendime të njëjta, pra bëjnë shumicën, nuk ka kuptim që mendimi i pakicës të prevalojë mbi mendimin e shumicës. P.sh, në rast se, projektvendimi sipas mendimit të një relatori të vetëm (relatorit të parë) shkon në komisioni i cili kuorumin e ka vetëm me të tre anëtarët që janë relatorë sepse, dy anëtarët e tjerë që, nuk janë relatorë mund të mos marrin pjesë në mbledhje për arsye të ndryshme të përligjura, atëherë automatikisht komisioni do të marri vendim sipas mendimit të shumicës. Dhe shumica në këtë rast përbëhet nga dy relatorëve që kishin mendim ndryshe nga relatori i parë i caktuar sipas shortit i cili ka paraqitur projektvendimin me mendimin e tij kundër shumicës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 18-19, të Raportit të Auditimit).

1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshoj dhe përmirësoj pikën 2 të nenit 23 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik të miratuar me VKPP nr.596, datë 12.09.2018, si më poshtë:

“Për çështje me vlerë të fondit limit më të lartë se kufiri i ulët monetar, çështja i caktohet me short tre anëtarëve. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre”.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të funksionimit të sistemit të ankimit për prokurimin publik, identifikuan problematika të ndryshme si:

- Përdorimi në mënyrë shpeshherë abuzive i instrumenteve të ankimit administrativ për prokurimet publike nga shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, gjë që ka shkaktuar një mbingarkesë të theksuar të KPP-së për këto lloj procedurash në krahasim me procedura të tjera;

- Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar se operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të informuar për formën, afatet dhe procedurat e përcaktuara nga ligji për ankimin administrativ për prokurimin publik. Kjo sjell në shumë raste mospranimin e ankesave të paraqitura vetëm për mosplotësim të kriterëve formale;

- Gjithashtu, mungesa e informacionit të operatorëve ekonomikë si për sistemin e ankimit ashtu dhe për kërkesat e përgjithshme të ligjit për procedurat e prokurimit, ka sjell shpeshherë ankime të formuluar me objekt të pasaktë, ose të paplotë, ç’ka e pengon KPP të evidentojë një gamë më të gjerë shkeljesh nga autoritetet kontraktore për shkak të kufizimit ligjor që ka për të mos dalë jashtë objektit të ankesës gjatë shqyrtimit të saj;

- Nga shqyrtimi i ankesave dhe procedurave është konstatuar se autoritetet kontraktore që shfaqin me dëndur tendencën për të gabuar në zbatimin e ligjit janë: autoritetet kontraktore me numër të

vogël punonjësish; autoritetet kontraktore të pushtetit vendor krahasuar me ato pushtetit qendror; (iii) autoritetet kontraktore që kanë pasur lëvizshmëri të lartë të zyrtarëve të prokurimit.

- Volumi shumë i madh i ankimeve që paraqiten në KPP, ka evidentuar nevojën që institucioni jo vetëm të shtojë numrin e stafit të angazhuar në procesin e shqyrtimit të ankimeve, por edhe domosdoshmërinë e përmirësimit të rregullave të prokurimit publik për rritjen e kualifikimit profesional të kapaciteteve njerëzore që lidhen me edukimin për procedurat dhe instrumentet e ankimit, qoftë të zyrtarëve të prokurimit të Autoriteteve Kontraktore, të Operatorëve Ekonomikë dhe të vetë punonjësve të KPP.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 50, të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, ti kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik që të marrë iniciativën ligjore për të bërë përmirësime në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e prokurimit publik, me qëllim eliminimin e problematikave të mësipërme të konstatuara në drejtim të funksionimit të sistemit të ankimit.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, ti kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik që të hartojë një komentari të posaçëm (broshurë) në të cilin të shpjegohen dhe të interpretohen qartësisht rregullat e prokurimit publik duke dhënë raste dhe shembuj të ndryshëm, me qëllim eliminimin e problematikave dhe shkeljeve që rezultojnë nga keqinterpretimet që Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë i bëjnë në përgjithësi rregullave të prokurimit publik dhe në veçanti funksionimit të sistemit të ankimit.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në nenit 22 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP që bënë fjalë për “Afati për vendimmarrjen” përcaktohet se:

1. *“Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës”.*

2. *“Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar”.*

3. *“Përrjashtimisht, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, për shkaqe të ligjshme, nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 15-ditor, duhet t’i bëjë të ditur palëve në proces, arsyet e mos marrjes së këtij vendimi. Nga ky moment, brenda 15 ditëve, Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës”.*

Në zbatim të pikës 1 dhe 2 të këtij neni, afati normal i Komisionit për shqyrtimin e një ankese është përcaktuar 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të dërguar nga Autoritetet Kontraktore. Autoritetet Kontraktore në zbatim të pikës 8 të nenit 63 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” duhet të dërgojnë në KPP, informacionin apo dokumentacionin e kërkuar brenda 5 ditëve. Pra afati maksimal normal i shqyrtimit të ankesave nuk është më shumë se, 20 ditë. Ndërsa sipas pikës 3 të këtij neni, në rastet përjashtimore, për shkaqe të ligjshme, Komisioni nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit 15-ditor, duhet t’i bëjë të ditur palëve në proces, arsyet e mos marrjes së këtij vendimi dhe nga ky moment, brenda 15 ditëve, ka detyrimin për të dalë me vendimin përfundimtar për shqyrtimin e ankesës.

Pra në rastet përjashtimore afati maksimal i shqyrtimit të ankesës mundë të shkojë deri në 35-40 ditë, por jo më shumë.

Nga auditimi mbi respektimin e afateve të shqyrtimit të ankesave nga KPP u konstatua:

Për periudhën 1 shtator 2017 deri më 31 dhjetor 2017:

-Për 2 ankesa ka përfunduar shqyrtimi administrativ pasi ankuesit kanë hequr dorë nga ankesa me vullnetin e tyre.

-Për 113 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk kanë qëndruar dhe ankesat nuk janë pranuar.

-Për 98 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ duke pranuar pretendimet e ankuesve.

-Për 4 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk janë marrë në shqyrtim dhe procedurat janë anuluar për shkak të veprimeve të paligjshme të autoriteteve kontraktore që lidhen me vendosje të kriterëve të paligjshme, të paqarta e konfuze që nuk kanë bërë të mundur shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve në fazën e vlerësimit të ofertave (kryesisht procedurat e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike).

-Për 9 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk janë marrë në shqyrtim në rastet kur është rikthyer për procedurë autoritetit kontraktor (rastet e ofertës anomalisht të ulët, rastet kur nuk janë dhënë në SPE arsyet e skualifikimit të detajuara, rastet kur AK nuk hedh të sakta ofertat ekonomike në SPE sipas formularit të ofertave –rasti i rojeve, nuk legjitimohet pasi nuk ngre pretendime për të tjerët të kualifikuar mbi veten e tij kur vetë është i skualifikuar, ose ngre pretendime për disa mbi veten e tij të kualifikuar ndërkohe që nuk i ka ankimuar të gjithë pasi ngelet dhe një tjetër mbi vete – rojet, etj)

-Për 1 ankesë është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesit janë shqyrtuar dhe pranuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk ekziston më si objekt ankesë në KPP.

Sa me sipër në këtë periudhë janë paraqitur 227, nga të cilat 42 ankesa ose 18% e tyre janë shqyrtuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” dhe nenit 22 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik*”. Ndërsa 185 ankesa ose 82% e tyre janë shqyrtuar brenda afatit ligjor në përputhje me këtë bazë ligjore.

Për periudhën 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018:

-Për 32 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi ankuesit kanë hequr dorë nga ankesa me vullnetin e tyre.

Për 609 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk kanë qëndruar dhe ankesat nuk janë pranuar.

-Për 450 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ duke pranuar pretendimet e ankuesve.

-Për 41 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk janë marrë në shqyrtim dhe procedurat janë anuluar për shkak të veprimeve të paligjshme të autoriteteve kontraktore që lidhen me vendosje të kriterëve të paligjshme, të paqarta e konfuze që nuk kanë bërë të mundur shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve në fazën e vlerësimit të ofertave (kryesisht procedurat e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike).

-Për 11 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk janë marrë në shqyrtim në rastet kur është rikthyer për procedurë autoritetit kontraktor (rastet e ofertës anomalish të ulët, rastet kur nuk janë dhënë në SPE arsyet e skualifikimit të detajuara, rastet kur AK nuk hedh të sakta ofertat ekonomike në SPE sipas formularit të ofertave –rasti i rojeve, nuk legjitimohet pasi nuk ngre pretendime për të tjerët të kualifikuar mbi veten e tij kur vetë është i

skualifikuar, ose ngre pretendime për disa mbi veten e tij të kualifikuar ndërkohe që nuk i ka ankuar të gjithë pasi ngelet dhe një tjetër mbi vete – rojet, etj.)

Për 15 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankimuesit janë shqyrtuar dhe pranuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk ekziston më si objekt ankese në KPP.

Sa sipër në këtë periudhë janë paraqitur 1158, nga të cilat 722 ose 62% e tyre janë shqyrtuar jashtë afatit jashtë afatit të përcaktuar në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 22 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik”. Ndërsa 436 ose 38% e tyre janë shqyrtuar brenda afatit ligjor.

Për periudhën 1 janar 2019 deri më 30.09. 2019 kemi këto statistika:

Për 32 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi ankimuesit kanë hequr dorë nga ankesa me vullnetin e tyre.

Për 372 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankimuesve nuk kanë qëndruar dhe ankesat nuk janë pranuar.

-Për 287 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ duke pranuar pretendimet e ankuesve.

Për 115 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk janë marrë në shqyrtim dhe procedurat janë anuluar për shkak të veprimeve të paligjshme të autoriteteve kontraktore që lidhen me vendosje të kriterëve të paligjshme, të paqarta e konfuze që nuk kanë bërë të mundur shqyrtimin e pretendimeve të ankuesve në fazën e vlerësimit të ofertave (kryesisht procedurat e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike).

Për 9 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesve nuk janë marrë në shqyrtim në rastet kur është rikthyer për procedurë autoritetit kontraktor (rastet e ofertës anomalish të ulët, rastet kur nuk janë dhënë në SPE arsyet e skualifikimit të detajuara, rastet kur AK nuk hedh të sakta ofertat ekonomike në SPE sipas formularit të ofertave –rasti i rojeve, nuk legjitimohet pasi nuk ngre pretendime për të tjerët të kualifikuar mbi veten e tij kur vetë është i skualifikuar, ose ngre pretendime për disa mbi veten e tij të kualifikuar ndërkohe që nuk i ka ankuar të gjithë pasi ngelet dhe një tjetër mbi vete – rojet, etj)

Për 5 ankesa është përfunduar shqyrtimi administrativ pasi pretendimet e ankuesit janë shqyrtuar dhe pranuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk ekziston më si objekt ankese në KPP.

Sa sipër, përgjatë kësaj periudhe janë paraqitur gjithsej 823 ankesa , nga të cilat 264 ose 32% janë shqyrtuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 22 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik”. Ndërsa 559 68% e tyre janë shqyrtuar brenda afatit ligjor.

Për sa u trajtua më sipër për mos respektimin e afateve të vendimmarrjeve të KPP, dolëm në konkluzionin se:

-Shqyrtimi i ankesave jashtë afatit sidomos numri i lartë në vitin 2018, I cili është raportuar edhe nga vetë KPP në Kuvendin e Shqipërisë, ka ardhur për shkak se institucioni ka qenë në procesin e konstituimit për shkak të kalimit në institucion të pavarur dhe u krijuar një vakum kohor;

-Shtimi i rasteve të ankesave gjate vitit 2017, 2018 dhe 2019 të krahasuara me vitet e mëparshme;

-Shkak tjetër është ardhja me vonesë e informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor; dosjet kanë qenë problematike, voluminoze apo të komplikuar që kanë dashur marrjen e informacionit të duhur edhe nga organe të tjera kompetente – verifikime në organet që I kanë lëshuar

dokumentet, ballafaqime etj. Megjithëse, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 në nenin 72 përcakton edhe penalitete për autoritetet kontraktore në raste të vonesave të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar nga KPP, në asnjë raste KPP nuk ka kërkuar pranë APP marrjen e masave për vendosjen e panaliteteve.

-Gjithashtu shkak tjetër objektiv për vonesat në shqyrtimin e ankesave brenda afatit është numri i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore. Konkreisht:

Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017 është miratuar në total me 30 punonjës, ku Sektori i Shqyrtimit të Ankesave, përbëhet nga 15 punonjës: 1 Përgjegjës Sektori dhe 14 Inspektorë, nga të cilët Përgjegjës Sektori dhe 5 pozicione inspektorë kanë qenë vakante (6 pozicione gjithsej).

Për vitin 2018 strukturës së Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet rekrutimeve të zhvilluara nga Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i është shtuar edhe një inspektor, duke e çuar numrin e tyre në 10, dhe duke ulur njëkohësisht vakancat në 4 inspektorë.

Struktura e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2019 është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 85/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik”, në total me 36 punonjës, ku Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave, përbëhet nga 17 punonjës: 1 Drejtor dhe 16 Inspektorë. Deri më muajin Korrik 2019 numri i inspektorëve të emëruar në KPP ka qenë i njëjtë me atë të vitit 2018, dhe pas kësaj periudhe ai është reduktuar në 9, pasi është plotësuar pozicioni vakant i Drejtorit të Drejtorisë së Ankesave. Është për tu theksuar fakti se, gjatë vitit 2019 Komisioni i Prokurimit Publik ka hapur procedurat e rekrutimit për 3 pozicione inspektorë, por janë mbyllur pa fitues.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 20-49, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të filloi menjëherë procedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve vakantë të organikës së Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të kërkojë Kuvendit të Shqipërisë, përmirësimin dhe shtimin e organikes së Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave me inspektorë të tjerë, për të mundësuar që të gjitha ankesat e të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

1.3. Rekomandimi: Në raste të vonesave të dërgimit të dokumentacionit nga Autoritetet Kontraktore, Komisioni i Prokurimit Publik, të kërkojë, Agjencisë së Prokurimit Publik marrjen e masave për vendosjen e panaliteteve për Titullarët e Autoritetet Kontraktore.

Afati i zbatimit:

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në pikën 4 të nenit 28 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KPP që bënë fjalë për “Shqyrtimi në themel”, përcaktohet se:

“Gjatë mbledhjeve mbahet procesverbal, i cili përmban edhe rezultatet e votimit të anëtarëve. Procesverbali nënshkruhet nga personi që e mban atë dhe nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje”.

U konstatua se, nuk mbahej procesverbal i zgjeruar ku të përshkruheshin të gjitha diskutimet e çdo anëtari të Komisionit por nga ana formale mbahej procesverbal i firmosur nga anëtarët, ku

përskruhej vetëm dispozitivi i vendimit, që do të marri Komisioni, pa trajtuar të gjitha diskutimet dhe mendimet të çdo anëtari.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19, të Raportit të Auditimit).

2. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo mbledhjeve të mbaje procesverbal të hollësishtëm mbi çdo çështje të diskutuar nga anëtarët e KPP, si dhe ky procesverbal të firmoset nga mbajtësi i tij dhe nga anëtarët e KPP.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në nenit 30 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP që bënë fjalë për “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës”, përcaktohet se:

1. “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë”.
2. “Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”.

U konstatua se, në disa raste operatorët që kanë pasur ofertat ekonomike më të ultë se pjesëmarrësit e tjerë dhe janë skualifikuar nga KVO, kanë bërë ankesë në KPP duke paraqitur dy objekte ankimi. Konkretisht kanë bërë ankesë për skualifikim të padrejtë të tyre dhe kualifikim të pa drejtë të operatorit të shpallur fitues, që ka ofertë më të lartë se operatori që ankohet. Ndërsa KPP, fillimisht ka shqyrtuar në themel vetëm objektin ankimit që ka lidhje direkt me interesat e ligjshme të operatorit ankues. Dhe kur ka vendosur që ankesa e këtij operatori për skualifikim të pa drejtë, nuk pranohet, nuk ka shqyrtuar në themel edhe objektin tjetër të ankesës që ka të bëjë me kualifikimin e padrejtë të operatorit që është kualifikuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 49, të Raportit të Auditimit).

3.Rekomandimi: Për rastet e procedurave të prokurimeve me vlerë të fondit limit më të lartë se kufiri i ulët monetar dhe kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të Autoritetit Kontraktor të vërejtura gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik të shqyrtoj në themel dhe të vendos për ligjshmërinë e të gjitha objekteve të ankimit.

Afati i zbatimit

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në nenit 12 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP që bënë fjalë për rendin e ditës, përcaktohet se:

“Kryetari i Komisionit e, në mungesë të tij, nënkryetari, vendos për rendin e ditës, duke mbajtur parasysh njoftimet, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 8, të kësaj rregulloreje; në rendin e ditës duhet të përfshihen çështjet e propozuara nga anëtarët e Komisionit, sipas pikës 3, të këtij neni, si dhe çdo çështje tjetër në kompetencë të tij; njoftimi i anëtarit relator drejtuar kryetarit për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 (tre) ditë përpara thirrjes së mbledhjes; rendi i ditës duhet t’u njoftohet me shkrim anëtarëve të Komisionit, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 8, të kësaj rregulloreje”

U konstatua se, në dosjet e shqyrtimit të ankesave nuk lihej gjurmë me shkrim nga relatorët për njoftim e Kryetarit të Komisionit për futje e një çështje në rendin e ditës përpara thirrjes së mbledhjes, por njoftimet bëheshin nëpërmjet sistemit elektronik nëpërmjet e-mailit, të cilat nuk printoheshin dhe nuk futeshin në inventarin e dosjeve.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19, të Raportit të Auditimit).

4. Rekomandimi: Në çdo dosjet të shqyrtimit të ankesave të gjitha njoftimet që bëhen në nëpërmjet sistemit elektronik duhet të printohen dhe të përfshihen në inventarët e dosjeve përkatëse të çdo ankese.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: KPP rast pas rasti ka shqyrtuar ankesa të cilat kanë pasur si objekt respektimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore, të lidhura kryesisht me, ankesat e paraqitura për dokumentet e tenderit dhe ankesat e paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave. Kështu:

Për vitin 2017, nga 1039 ankesa në total, 278 prej tyre ose 26,7 % janë ankesa të paraqitura vetëm për dokumentet e tenderit. *Nga këto, 132 janë ankesa për dokumentet e tenderit të paraqitura në procedura prokurimi për shërbimet e ruajtjes fizike.*

Po kështu dhe për vitin 2018, nga 1158 ankesa në total, 225 prej tyre ose 19.43 % janë ankesa të paraqitura për dokumentet e tenderit. *Nga këto, 91 janë ankesa për dokumentet e tenderit të paraqitura në procedura prokurimi për shërbimet e ruajtjes fizike.*

Në këto rrethana, unifikimi dhe bërja e detyrueshme e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për procedura të njëjta ose të ngjashme, do të rezultonte me ulje të ndjeshme të numrit të ankesave me këtë objekt.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 50, të Raportit të Auditimit).

5. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të marri iniciativën ligjore dhe ti kërkojë Agjencisë së prokurimit Publik, unifikimi dhe bërja e detyrueshme të një pakete kriteresh minimale të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për procedura të prokurimeve të njëjta ose të ngjashme

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Sipas nenit 21, të rregullores për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik të miratuar me VKPP nr.596, datë 12.09.2018, ankesat paraqiten në mënyrë elektronike në selinë e Komisionit dhe regjistrohen menjëherë, përveçse kur sipas legjislacionit në fuqi parashikohet një mjet tjetër komunikimi.

U konstatua se , ne asnjë rast që nga momenti i krijimit të Komisionit, ankesat nuk janë paraqitur në mënyrë elektronike, por janë paraqitur manualisht (hard copy) në rrugë postare.

Paraqitja e ankesave vetëm në rrugë postare dhe jo elektronikisht është bërë sepse këtë shërbim nuk e afron sistemi elektronik i prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Me gjithë përpjekjet e herëpashershme të KPP dhe APP, për të mundur funksionim normal të sistemit elektronik në lidhje me paraqitjet e ankesave në mënyrë elektronike, ky proces ka qenë teknikisht i pamundur për ty zbatuar nga KPP dhe APP. Ky proces lidhet ngushtësisht me pagesat e tarifave të ankimit që operatorët duhet ta derdhin tarifën në thesar nëpërmjet bankës dhe mandat pagesën duhet ta dorëzojnë në KPP së bashku me ankesën. Pra, KPP nuk e merr në dorëzim dhe në shqyrtim ankesën qoftë të paraqitur në rrugë elektronike apo edhe manualisht (hard copy) në rrugë postare, pa u dorëzuar më parë dorazi nga operatorët mandat pagesa e tarifës së ankimit. Ky proces teknikisht e bënë të panevojshme paraqitjen e ankesave në rrugë elektronike, çka ndikon në shpejtësinë dhe efikasitetin e procesit të shqyrtimit të ankesave si dhe në afatet e Vendimmarrjeve të KPP .

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17, të Raportit të Auditimit).

6. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Agjencinë së Prokurimit Publik ti kërkojnë Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Thesarit) që të rregullojnë procesin e

paraqitjes së tarifës së ankimit me qëllim eliminimin e pengesave për funksionim normal të paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomik nëpërmjet sistemit elektronik të APP.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në nenin 21, përcaktohet se, Komisioni mban një regjistër të posaçëm elektronik për regjistrimin e ankesave, i cili publikohet në faqen zyrtare; formati i standardizuar i regjistrimit miratohet nga kryetari i Komisionit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

U konstatua se, është mbajtur në mënyrë të përditësuar regjistër elektronik i regjistrimit të ankesave i cili publikohet edhe në faqen zyrtare, por nuk ka manualisht një format të miratuar dhe standardizuar të këtij regjistri.

-KPP-së ka krijuar regjistrin elektronik për të gjithë ankesat e paraqitura ne KPP nga ankuesit, por ku regjistër nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara sipas nenit 21 të Vendimit nr.596, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 6-13 dhe 17, të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik të hartoi dhe miratoi formatin standard të një regjistër të posaçëm elektronik të regjistrimit e ankesave.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

7.2. Rekomandimi: KPP të marrë masa për përmirësimin e regjistrimit elektronik të ankesave në përputhje me kërkesat e rregullores për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në nenin 9, të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP, që bënë fjalë për “Inspektorët dhe personeli ndihmës”, përcaktohet se:

“Inspektorët e Komisionit që ushtrojnë funksione ndihmëse dhe këshillimore për anëtarët e Komisionit, në kuadër të shqyrtimit të ankesave, si dhe çdo detyrë tjetër të caktuar nga kryetari ose Komisioni në funksion të shqyrtimit të ankesave dhe rregulla të detajuara mbi detyrat e inspektorëve dhe personelit ndihmës, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Komisionit”.

U konstatua se, është hartuar rregullore e brendshme Komisionit të Prokurimit Publik dhe është miratuar me Urdhrin nr.39, datë 05.02.2019 të Kryetarit të KPP, por në këtë rregullore nuk janë përcaktuar dhe nuk janë përfshirë, rregulla të detajuara mbi detyrat e inspektorëve dhe personelit ndihmës, sipas kërkesës së sipërcituar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 18, të Raportit të Auditimit).

8. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të hartojë dhe të përfshijë, në rregulloren e brendshme të institucionit, rregulla të detajuara mbi detyrat e inspektorëve dhe të personelit ndihmës.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në nenin 10 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP, që bënë fjalë për “Specialistët e pavarur dhe ekspertët” përcaktohet se: *“Komisioni miraton listën vjetore të specialistëve dhe ekspertëve të pavarur të Komisionit për vitin pasues kalendarik me të paktën dy specialistë/ekspertë për çdo fushë ekspertize; Lista vjetore e specialistëve dhe ekspertëve*

krijohet brenda datës 10 dhjetor, të çdo viti, në bazë të renditjes së kandidatëve të paraqitur pas konkurrimit me jetëshkrime; Rregulla më të hollësishme për krijimin e listës dhe konkurrimit të kandidatëve përcaktohen në rregulloren e brendshme të Komisionit”.

U konstatua se, edhe kjo kërkesë e kësaj rregulloreje nuk është përfshirë në rregullore e brendshme të institucionit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 18, të Raportit të Auditimit).

9. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të hartojë dhe të përfshijë, në rregulloren e brendshme të institucionit, rregulla të hollësishme për krijimin e listës dhe konkurrimit të kandidatëve për specialistët e pavarur dhe të ekspertëve.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në nenin 25 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP që bënë fjalë për “Pjesëmarrja dhe detyrat e inspektorëve”, përcaktohet se: “Komisioni cakton me short inspektorët sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e brendshme”.

U konstatua se, në rregulloren e brendshme të Komisionit të Prokurimit Publik të miratuar me Urdhrin nr.39, datë 05.02.2019 të Kryetarit të KPP nuk janë përcaktuar dhe nuk janë përfshirë, rregulla të detajuara për procedurën e zgjedhjeve të inspektorëve me short, sipas kërkesës së sipërcituar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 19, të Raportit të Auditimit).

10. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të hartojë dhe të përfshijë, në rregulloren e brendshme të institucionit, rregulla të detajuara për procedurën e zgjedhjeve të inspektorëve me short, sipas kërkesës së sipërcituar.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në pikën 1 të nenit 23 të rregullores për organizimin dhe funksionimit e KPP që bënë fjalë për “Caktimi i çështjeve dhe njohja me aktet”, përcaktohet se:

“Për çdo çështje të ankimuar, Komisioni, cakton me short, sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e brendshme, si relator një nga anëtarët e tij duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet anëtarëve.

U konstatua, megjithëse në çdo raste relatorët e çështjeve janë përzgjedhur nëpërmjet hedhjes së shortit, në rregullore e brendshme të miratuar me Urdhrin nr.39, datë 05.02.2019 të Kryetarit të KPP, nuk është përcaktuar procedura e zgjedhjes së relatorit të çështjeve ndërmjet anëtarëve sipas kërkesës të nenit të sipërcituar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 18, të Raportit të Auditimit).

11. Rekomandimi: Komisioni i Prokurimit Publik, të hartojë dhe të përfshijë, në rregulloren e brendshme të institucionit procedurën e zgjedhjes së relatorit të çështjes.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Prokurimit Publik, ka hartuar dhe miratuara rregulloren për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik me Vendimin nr.596, datë 12.09.2018. Sipas përcaktimit të vetë kësaj rregulloreje, këto rregulla hynë në fuqi 15 ditë mbas

miratimit nga Komisioni i Prokurimit Publik. Por u konstatua se kjo rregullore nuk është botuar në fletoren zyrtare.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17, të Raportit të Auditimit).

12. Rekomandimi: Komisioni të Prokurimit Publik të kërkojë ekspertizë pranë kuvendit të Shqipërisë për ligjshmërinë e botimit të rregulloren për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik me Vendimin nr.596, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Afati i zbatimit:

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi si dhe vlerësimi nga grupi i auditimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për periudhën e auditimit 01.09.2017 – 30.09.2019 , rezultoi:1.1. Raporti për cilësinë e sistemeve te kontrollit te brendshëm i përgatitur nga Komisioni Prokurimit Publik, përmban informacion si dhe të dhëna mbi të pestë (5) komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrolli siç janë, Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Aktivitete e Kontrollit , Informimi dhe Komunikimi si dhe Monitorimi dhe Raportimi por nga *auditimi u konstatua se për vitin 2017*, nuk janë trajtuar rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në kundërshtim më manualin e menaxhimit Financiar i miratuar me urdhrin e Ministrisë së Financave nr.108 datë 17.11.2016 i cili citon se “*Raporti Vjetor duhet të bazohet në, gjetjet e audituesve te brendshëm dhe të jashtëm*”.

13.1. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues si dhe menaxherët e tjerë te institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 15 “*Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave*”, si dhe Kapitulli III “*Delegimi i detyrave*”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia, *institucioni nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.*

13.2. Nga auditimi u konstatua se KPP *nuk ka program specifike për trajnimin e punonjësve të administratës i cili duhet të përgatitet çdo fillim viti mbi nevojat për trajnim për secilin nga Drejtoritë apo Sektorët si dhe duke përgatitur ne fund të çdo viti planin mbi realizimin e trajnimeve nga punonjësit e institucionit, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “*Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)*”, paragrafët “*Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore*” dhe “*Profesionalizmi i stafit*”.*

(Trajtuar më hollësisht në faqet 6-13, të Raportit të Auditimit).

13.3 Rekomandimi: Gjate hartimit të raportit mbi cilësinë e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, te merret masa për trajtimin ne kapitullin III, të rekomandimeve të kontrollit të jashtëm apo te brendshëm (atëherë kur institucioni ka), si dhe masat qe janë mare për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

13.4. Rekomandimi: Të marren masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës. Gjithashtu, institucioni të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Rekomandimi: Gjithashtu të marrë masa në hartimin dhe miratimin lidhur me delegimin e kompetencave në rregulloren e brendshme duke trajtuar delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me dorëzimin dhe regjistrimit e ankesave të paraqitura pranë KPP-së konstatohet se, është krijuar regjistri elektronik për të gjithë ankesat e paraqitura ne KPP nga ankuesit, por ku regjistër nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara sipas nenit 21 të Vendimit nr.596, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik’.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 6-13, të Raportit të Auditimit).

14. Rekomandimi: KPP të marrë masa për përmirësimin e regjistrit elektronik të ankesave në përputhje me kërkesat e rregullores për organizimin dhe funksionimit e Komisionit të Prokurimit Publik.

Afati i zbatimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

C. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë KPP për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, reflektimin e tyre dhe përmirësimin e punës dhe proceseve në shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve publike, koncensioneve dhe ankandeve publike.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ

GRUPI I AUDITIMIT

Bashkim Arizaj

Fatmir Zilja

Eni Kabashi